

URDHËR
Nr. 570, datë 30.9.2022

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të kryetarit të Komisionit të Njohjes dhe Njësimit të Gradave Shkencore (KNJG), znj. Albana Tole, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit.
2. Kompetencat e deleguara të kryetarit të Komisionit të Njohjes dhe Njësimit të Gradave Shkencore (KNJG), do të ushtrohen deri në shfuqizimin e këtij urdhri, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegates apo të deleguar.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri znj. Albana Tole, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi